1.20. Projekti: "Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit në fshatin Raushiq", Komuna e Pejës në vlerë prej 104,000.00€;

1.21. Projekti: "Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit në rrugën Isa Haxhijaj në fshatin Dubovë", Komuna e Pejës në vlerë prej 52,800.00€;

1.22. Projekti: "Ndërtimi i trotuarit pran stacionit te autobusëve", Komuna e Pejës në vlerë prej 48.000,00€;

1.23. Projekti: "Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Llozhan deri tek shkolla", Komuna e Pejës në vlerë prej 34,400.00€;

1.24. Projekti: "Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në lagjen Asllan Qeshme, Rregullimi i hapësirës publike në Qendrën Zejtare dhe te Ura e Gurit", Komuna e Pejës në vlerë prej 64,000.00€;

1.25. Projekti: "Ndërtimi i hapësirës publike në fshatin Koshutan", Komuna e Pejës në vlerë prej 32,000.00€;

1.26. Projekti: "Kubëzimi i hapësirave publike në lagjen Fidanisht", Komuna e Pejës në vlerë prej 96,000.00€;

1.27. Projekti: "Ndriçimi i hapësirave publike në lagjen Fidanisht", Komuna e Pejës në vlerë prej 52,000.00€;

1.28. Projekti: "Ndërtimi i hapësirës për rreth stadiumit në fshatin Brestovik", Komuna e Pejës në vlerë prej 56,000.00€;

1.29. Projekti: "Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirës publike tek Uji i Zi dhe ndërtimi murit dhe ndriçimi tek Zelkiqt", Komuna e Pejës në vlerë prej 102,800.00€;

1.30. Projekti: "Ndërtimi i shtëpisë së fshatit për nevoja të ndryshme të banorëve të fshatit Ozdrim", Komuna e Pejës në vlerë prej 63,511.51€;

1.31. Projekti: "Ndërtimi i Ambulantës në fshatin Trestenik", Komuna e Pejës në vlerë prej 96,000.00€;

1.32. Projekti: "Ndërtimi i trotuarit në fshatin Kliqinë, Leshan, Gllaviqicë dhe Jabllanicë", Komuna e Pejës në vlerë prej 40,797.64€;

1.33. Projekti: "Pastrimi i deponive ilegale dhe rregullimi i parqeve në Komunën e Parteshit", në vlerë prej 8,414.04€.

2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 14/203**
**Datë: 08.05.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 7, 8, 39 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejmë i kërkesës për shpronësim dhe krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi Nënstacionit NS 220/35/10 (20) kV Malisheva dhe Linja Transmetuese 220 kV Dragobil" në Qytetin e Malishevës, Zona Kadastrale: Dragobil, Komuna Malishevë në dobi të Subjektit Kërkues/Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A), sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".

3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L.-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A).

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 15/203**
**Datë: 08.05.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 të Rregullores Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit ne Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Emërohet Komisioni ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, në këtë përbërje:

    1.1. Naim Gashi, Drejtor i Përgjithshëm/Agjencia e Kosovës për Akreditim, kryesues;
    1.2. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, anëtar;
    1.3. Fahrije Tërnava - Sheremeti, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, anëtare;
    1.4. Ejup Fejza, (ekspert i jashtëm), anëtar;
    1.5. Ismet Mecinaj, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Ministria e Mbrojtjes, anëtar.

2. Obligohet Komisioni që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij siç parashihet në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 16/203**
**Datë: 08.05.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Rrugës Prizren-Kufiri me Maqedoninë e Veriut (Tetovë) segmenti Struzhë-Kyçja me Autoudhën "Ibrahim Rugova" në Prizren - Jug, L=20.350km, Zonat Kadastrale: Prizren, Vllashnje, Leskovec, Jabllanicë dhe Kushtendil, Komuna Prizren, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuara nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme /Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit konform legjislacionit në fuqi.

8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.

9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeminstër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 17/203**
**Datë: 08.05.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

## V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh "Juogopetroll" parcela kadastrale Nr.1817-0 dhe Objektin që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, i cili gjendet në parcelën Nr.1318-1 në pronësi të Komunës së Rahovecit, shpronësimi i të cilave është i nevojshëm për realizimin e Projektit: "Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit", Zona Kadastrale: Rahovec, Komuna Rahovec, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është raporti i vlerësimit i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues-Komuna e Rahovecit, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, konform legjislacionit në fuqi.

8. Subjekti Kërkues-Komuna e Rahovecit, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.

9. Ky Vendim, bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.

10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 18/203**
**Datë: 08.05.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

# V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme Objekti i ish Ndërmarrjes Shoqërore "Liria" Prizren, që gjendet në parcelën Kadastrale Nr.4792-0, pronë komunale, ZK Prizren, Komuna Prizren e cila është e nevojshme për realizimin e Projektit: "Krijimi i hapësirave për lëvizshmërinë e trafikut dhe këmbësorëve" sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij Vendimi është raporti i vlerësimit i punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme / Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabela e bashkëngjitur këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për tokën për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.

4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij Vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues-Komuna e Prizrenit, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij Vendimi, komfor legjislacionit në fuqi.

8. Subjekti Kërkues-Komuna e Prizrenit, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.

9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Zyra Kadastrale Komunale është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.

10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 19/203**
**Datë: 08.05.2024**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Shërbime Ajrore ndërmjet Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 20/203
Datë: 08.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 të Rregullores Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit ne Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

## V E N D I M

1. Emërohet Komisioni ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në këtë përbërje:

   1.1. Bekim Hoxha, U. D. Kryeshef në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, kryesues;
   1.2. Besim Kamberaj, U. D. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, anëtar;
   1.3. Izedin Bytyqi, U. D Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar;
   1.4. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar;
   1.5. Mihrije Shaljani, Udhëheqëse e NjMBNj në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtare.

2. Obligohet Komisioni që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij siç parashihet në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 21/203
Datë: 08.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 22/203
Datë: 08.05.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 23 të Rregullores Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit ne Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2024, merr këtë:

# V E N D I M

2. Emërohet Komisioni ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në këtë përbërje:

   2.1. Izedin Bytyqi, U.D. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kryesues;
   2.2. Leonita Shabani-Mullarama, U. D. Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë, anëtare;
   2.3. Besim Kamberaj, U. D. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, anëtar;
   2.4. Lulzim Aliaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar;
   2.5. Safete Selmani, Udhëheqëse e NjMBNj në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

3. Obligohet Komisioni që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij siç parashihet në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë